

20121002626

L I G J
PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE TE BANKA EVROPIANE
PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM SIPAS MARREVESHJES PËR HUA PËR
PROJEKTIN "REHABILITIMI I PJESES LINDORE TË HEKURUDHES SË
KORRIDORIT VIII, FAZA 1-SEGMENTI KUMANOVE-BELAKOVÇ"

Neni 1

Republika e Maqedonisë merr hua te Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në shumë prej 46 400 000 eurosh, të dedikuar për realizimin e projektit "Rehabilitimi i pjesës lindore të hekurudhës së Korridorit VIII, faza 1 -segmenti Kumanovë-Belakovç".

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua për projektin "Rehabilitimi i pjesës lindore të hekurudhës së Korridorit VIII, faza 1 - segmenti Kumanovë-Belakovç", që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave apo personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej katër vitesh.

Shkalla e kamatës është variabile dhe përbëhet prej EURIBOR gjashtëmujor, të rritur për margjinë prej 1%. Shkalla e kamatës paguhet në nivel vjetor.

Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në lartësi prej 1% nga shuma e huas.

Për shumën e mjeteve të patërhequra nga huaja Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim do t'i paguhet provizion në lartësi prej 0,5 % nga shuma e mjeteve të patërhequra të huas. Provizioni i mjeteve të patërhequra paguhet në nivel vjetor.

Neni 4

Projektin do ta implementojë Ministria e Transportit dhe Lidhjeve nëpërmjet Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat Maqedonase" - Shkup, që do të lidhin Marrëveshje për implementimin dhe për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella.

Neni 5

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".